



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KRYETARI

Nr. _____ Regj.

Ballsh, më ____ . ____ . 2020

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën www.app.gov.al

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 27.10.2020

Për: **Operatorin Ekonomik “ALSTEZO” sha, me NIPT J63208420N, me adresë Lagjja “Kryengritja e Fierit”, Fier.**

* * *

Procedura e prokurimit: **“Kërkesë për propozim”**

Numri i references së procedurës: **REF-73388-09-29-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje filtra dhe vaj motorri e hidrauliku”** (për nevoja të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Mallakastër), me fond limit **1,009,600** (një milion e nëntë mijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH**, me afat 15 ditë.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.82, datë 5 dhjetor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ALSTEZO” shpk, me NIPT J63208420N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 897,500 (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH

2. **Operatori Ekonomik “ELBA-OIL 2015 SHA” sha**, me NIPT L52606201T, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **634,000** (gjashtëqind e tridhjetë e katërmijë) **lekë pa TVSH**
3. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “KriBuild” shpk**, me NIPT L93313401R & **“EXIMOIL” sha**, me NIPT K91715006E, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **857,570** (tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë) **lekë pa TVSH**
4. **Operatori Ekonomik “POWER INDUSTRIES” shpk**, me NIPT L51706022H, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej **832,500** (tetëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Operatori Ekonomik “ELBA-OIL 2015 SHA” sha, me NIPT L52606201T, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:**
 - Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës “2.2.1.”, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur vërtetimi nga administrata tatimore lidhur me xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2017, 2018, 2019). Dokumenti i ngarkuar në SPE, me emërtim “VER_XHIRO_3_VITE”, nuk përmban të dhëna lidhur me xhiron e realizuar.
Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “ELBA-OIL 2015” sha nuk plotësohen këto kërkesa.
 - Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës “2.2.2.”, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur kopje e çertifikuar e bilancit të vitit 2019.
Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “ELBA-OIL 2015” sha nuk plotësohen këto kërkesa.
 - Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës “2.2.3.”, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi referuar dokumentit të ngarkuar në SPE, me emërtim “OSHEE” lëshuar nga OSHEE Elbasan, me nr.471/1 prot, datë 10.08.2020, rezulton se është paguar detyrimi për muajin Qershor 2020, ndërkohë që referuar datës së zhvillimit të kësaj procedure (12.10.2020), duhej të ishte paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike për muajt Korrik dhe Gusht 2020, muaj të cilët janë maturuar respektivisht në datat 31 Gusht dhe 30 Shtator 2020. Në nenin 26, pika 7, shkronja “c”, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se: “...Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ..”. Gjithashtu, në nenin 9 (Pagesa dhe afati për kryerjen e saj), paragrafi 9.1, i kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet se: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”.

Sa më sipër, referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit (12.10.2020) dhe përcaktimeve të bëra në vendimin e sipërcituar të ERE, rezulton se detyrimet e energjisë elektrike për muajt Korrik dhe Gusht 2020 janë maturuar dhe OE “ELBA-OIL 2015” sha nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimit të këtyre muajve, gjë e cila përbën shkak për skualifikim sipas nenit 26, pika 7, shkronja “c”, të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “ELBA-OIL 2015” sha nuk plotësohen këto kërkesa.

2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “KriBuild” shpk, me NIPT L93313401R & “EXIMOIL” sha, me NIPT K91715006E, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në pikën 1. “Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit”, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nga anëtari i BOE “KriBuild” shpk, nuk është paraqitur/dorëzuar vetëdeklarata me shkrim e subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “KriBuild” shpk & “Eximoil” sha nuk plotësohet kjo kërkesë.

- Gjithashtu, nuk plotëson një tjetër kërkesë të përcaktuar në pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet dy anëtarëve të bashkimit “KriBuild” shpk & “Eximoil” shpk, nuk janë paraqitur në formën e kërkuar (origjinal ose kopje e noterizuar), por është paraqitur fotokopje e thjeshtë. Gjithashtu marrëveshja është e paplotë, pasi nuk përcaktohet objekti i prokurimit dhe as përqindja e pjesëmarrjes, si dhe nuk është paraqitur as prokura e posaçme noteriale.

Në pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, ndër të tjera është përcaktuar se: “*Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen: a.Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht; b.Prokura e posaçme.*”.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “KriBuild” shpk & “Eximoil” sha nuk plotësohet kjo kërkesë.

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “KriBuild” shpk, nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”, “dh”, në pikën 1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk janë paraqitur deklaratat e kërkuara.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “KriBuild” shpk & “Eximoil” sha nuk plotësohet kjo kërkesë.

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “KriBuild” shpk, nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara sipas nënpikave “2.2.1.”, “2.2.2.”, “2.2.3.”, “2.2.4.”, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar në këto nënpika.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “KriBuild” shpk & “Eximoil” sha nuk plotësohet kjo kërkesë.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës “2.3.2.”, të kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur fletë analize për vajrat, të lëshuar brenda 6 muajve të fundit, nga institucione të autorizuar të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose nga prodhuesi që vërtetojnë pajtueshmërinë e mallit të prodhuar në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga BOE “KriBuild” shpk & “Eximoil” sha nuk plotësohet kjo kërkesë.

3. Operatori Ekonomik “POWER INDUSTRIES” shpk, me NIPT L51706022H, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës “2.2.1.”, të kapacitetit ekonomik dhe financiar, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur vërtetimi nga administrata tatimore lidhur me xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2017, 2018, 2019). Materiali i ngarkuar në SPE, me emërtim “NDF24f2f9c46f574234a8b2d18fa6029408”, nuk përmban të dhëna lidhur me xhiron e realizuar.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “Power Industries” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.

- Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar sipas pikës “2.3.2.”, të kapacitetit teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 8 të dokumentave standarte të tenderit, pasi materiali i ngarkuar me emërtimin “SKEDA_TEKNIKE_TE_PRODUESIT” nuk përmban të dhëna dhe nuk referon për analiza të kryera nga prodhuesi për llogari të ofertuesit.

Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “Power Industries” shpk nuk plotësohen kjo kërkesë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “ALSTEZO” sha, me NIPT J63208420N, me adresë Lagjia “Kryengritja e Fierit”, Fier**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **897,500** (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.10.2020

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Qerim Ismailaj